



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 3 , datë 28.01.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Janar, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 28.01.2022

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Rradhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë, dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi :** Përshëndetje të gjithëve ! Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare !

Shpresoj dhe uroj që të jeni të gjithë mirë Ju dhe familjet tuaja....

Mbajmë sot mbledhjen e rradhës për vitin 2022 për Këshillin Bashkiak Durrës.

Bashkë me Kryesinë e Këshillit kemi vendosur, që kjo mbledhje plenare të mbahej me mjete të komunikimit elektronik, pasi ky virus për fat të keq vazhdon të jetë prezent akoma midis nesh.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga znj.Emiriana Sako, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë si dhe informohemi mbi raportin 12 mujor të punës së Këshillit për vitin 2021.

Materialet, siç dhe jeni në dijeni, Ju janë vënë në dispozicion nga sekretaria e këshillit .

Ftoj Sekretaren e Këshillit të proçedoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

**Dorina Milja:** Faleminderit Kryetar ! Fillojmë me prezantimin.

Jolanda Mustafaraj ...Jolanda është në linjë ..... prezent..... Alfred Mullaraj ...ka votuar me email.....etj deri.... Morena Boja ..... mungon. Atëherë Kryetar, ke 32 këshilltarë, që u dëgjuan online.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Dori vetëm një sekond të lutem se është shtuar Orges Liperi, i cili është online dhe Afrim Bakaj, i cili është online

**Dorina Milja:** Po faleminderit . Atëherë Kryetar ke 34 online dhe 2 vota me email erdhën të tjera tani online, Klodi dhe Albani, dhe 6 vota me email.

*(Hyn gjatë rendit të ditës online Nuriye Gjoni dhe Indrit Cërloj, pra 36 këshilltarë online dhe 1 email erdhi gjatë mbledhjes Petrit Ismailati, pra 36 online dhe 7 vota me email).*

**Ani Dyrmishi** : Atëherë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen

Siç jemi njoftuar të gjithë nga sekretaria e këshillit bashkiak pikat që shtrohen sot për miratim janë 11, ku vazhdojmë me pikën e parë .....

<p><b>1.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR</p>
<p><b>2.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&amp;3 DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&amp;23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR</p>
<p><b>3.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të këshillit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT DHE KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 163, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SI DHE KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME SPORTIVE “BENARDINA QERRAXHIA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022”</p>
<p><b>4.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.22, DATË 25.02.2021 ”PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR.14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”</p>
<p><b>5.</b> Raportim Këshilltarëve</p>	<p>RAPORT PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT 2021</p>

## Pika shitesë

Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN JANAR 2022
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.17, DATË 22.02.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DYTË TË 22 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.22, DATË 25.02.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1062, RRUGA "26 NËNTORI" DHE PALLATIN NR.14, RRUGA "PETRAQ BOSHNJAKU", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 92, DATË 26.7.2021 "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 8,985,373.3 (TETËMILION E NËNTËQIND E TETËDHJETË E PESËMIJË E TREQIND E SHATËDHJETË E TRE LEKË E TRIDHJETË QINDARKA), PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTUI VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI "RIKONSTRUKSIONI DHE NDËRTIMI I RRUGËVE "KSANTHIPI ZYKO" DHE "ABDYL YPI"
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË TREMBËDHJETË ME SUBJEKTET PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NËNTË TË 6 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve ?

Atëherë s'kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi, votohet në chat).

Kundra? .....Apstenim? .....

Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votuar .

Eneida mundesh të ma konfirmosh ka përfunduar procesi i votimit.

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Jo ende nuk ka përfunduar Ani, presim dhe 2 kolege të votojnë. Etleva Budini dhe Zamira.

Ani kolegët kanë votuar të gjithë pro rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi :** Atëherë me me të gjitha votat pro miatohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1 të rendit të ditës**, i jepim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, zonjës.Klementina Meçi.

**Klementina Meçi :** Faleminderit Kryetar ! Përshëndetje të gjithëve !

Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale nëpërmjet komunikimeve elektronike mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dorëzuar nga drejtorja përkatëse e bashkisë me propozimin si më poshtë:

Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familjet përpara se të përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë nga pagesa PAK.

Gjithashtu dhe miratimi i kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të buxhetit të bashkisë

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familjet duhet të jenë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, që janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa si PAK.
- Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet që kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale, të cilët kanë vështirësi punësimi.
- Familjet rome, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.
- Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
- Familjet me kryefamiljare gra, që kanë të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.

Nga propozimi i mësipërm komisioni vendosi që ta kaloj këtë pikë për miratim në mbledhjen e sotme. Faleminderit !

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit!

Komente përsa i përket pikës 1 kemi?.....

Nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë.

Eneida kur të mbaroj procesi i votimit të lutem ma konfirmo.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Kolegët kanë votuar pro pikës 1.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me të gjitha votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në aneksin 1, të VKB-së nr. 32, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive.....” propozon në mënyrë unanime për ta kaluar këtë pikë . Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zonja Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zoti Jani.

**Elio Jani** : Përshëndetje të gjithëve !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit!

Komente përsa i përket pikës 2, kemi nga ana e këshilltarëve ?.....

Nuk kemi, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë.

Eneida kur të përfundoj procesi të lutem ma konfirmo.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Kolegët kanë votuar pro pikës 2.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me të gjitha votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **e pikës 3 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zonjës Jolanda Mustafaraj.

**Jolanda Mustafaraj** : Përshëndetje të gjithëve !

Për pikën 3 të rendit të ditës, Komisioni Arsimit vendosi : « Për miratimin e ndryshimit dhe korrigjimin e gabimit material në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 163, datë 23.12.2021 “Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar si dhe konviktit të shkollës së mesme sportive “Benardina Qerraxhia”, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2021-2022”, komisioni ra dakort.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 3, kemi nga ana e këshilltarëve ?.....

Nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë.

Eneida të lutem më konfirmo kur të përmbushet procesi i votimit.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Kolegët kanë votuar pro pikës 3.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Atëherë me të gjitha votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 4**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pas shqyrtimit të materialit për miratimin e ndryshimit të aneksit nr.1 në pallatin nr.1062, rruga “26 Nëntori”, propozon miratimin e pikës 1 gjithashtu dhe pikën 2 përçka bëhet fjalë për aneksin, e cila përbëhet në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.22, duke bërë ndryshimin e strukturës të përfituar nga z. Markeliano Avdia, si subjekt përfitues nga programi i procesit të rindërtimit në masën 2+1 duke përfshirë edhe znj.Arlinda Sotaj, sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5. Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike me shumicë votash propozon për ta kaluar pikën 4. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zonja Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zoti Jani.

**Elio Jani** : Faleminderit Kryetar !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike me shumicë votash propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit z.Jani !

Komente përsa i përket pikës 4, kemi nga ana e këshilltarëve ?.....

Nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votuar.

**Eneida Marku (asistenca teknike)**: Me 1 votë apstenim dhe të tjerat pro kolegët kanë përfunduar votimin.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me 1 votë apstenim dhe të tjerat pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë tek **pika 5**.

Përsa i përket pikës 5 besoj të gjithë e keni lexuar raportin. Për të mos u zgjatur shumë po e shpreh në vija të përgjithshme, pasi më të detajur e keni në raport, i cili do të bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit , kështu që do të jetë i aksesueshëm dhe për publikun .

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, eficientë dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Durrës është mbështetur në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli.

Edhe viti që kaluam ashtu sikur dhe viti para tij kanë qenë tepër sfidues, pasi përhapja e virusit Covid-19, detyroi përshtatjen me një realitet krejtësisht tjetër. U ridimensionuan plotësisht si marrdhëniet ekonomike shoqërore edhe ato të të punuarit apo ato të komunikimit në rafshin profesional dhe individual, kështu që Këshilli Bashkiak Durrës ka marrë masa dhe gjatë vitit 2021 për tu përshtatur me këtë qasje të re, duke garantuar vazhdimësinë dhe mirëfunksionimin e aktivitetit të këshillit si dhe përmbushjen me rigorozitet të detyrimeve ligjore

Për periudhën janar - dhjetor 2021, janë marrë 166 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Durrës. Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në: për probleme financiare - 51 vendime, për probleme sociale - 14 vendime, për infrastrukturën dhe strehimin - 55 vendime, për problemet urbane dhe asetet - 8 vendime, për emergjencat civile - 3 vendime, për probleme të arsimit kulturës - 15 vendime, të ndryshme - 20 vendime.

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2021 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra.

Siç shihet dhe nga kalendari i mbledhjeve gjatë muajit janar-dhjetor 2021, këshilli ka mbajtur 24 mbledhje

- 19 (nëntëmbëdhjetë) mbledhje të Këshillit janë zhvilluar online për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19,

- 5 (pesë) mbledhjeve, në sallën e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu” (duke zbatuar protokollin e sigurisë së institucionit, për masat e marra kundër Covid – 19, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).

Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online.

Për periudhën 12-mujore janë bërë 121 mbledhje të komisioneve të përhershëm, pjesa më e madhe prej tyre janë mbajtur online në kushtet e pandemisë.

Gjatë 12 mujorit janë dorëzuar 280 raporte të mbajtura nga komisionet e përhershëm.

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përcimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka hapur faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjjerime nga qytetarë të ndryshëm. Katër mbledhje plenare të këshillit janë transmetuar direkt dhe nëpërmjet këtij rrjeti, ku komuniteti ka ndjekur direkt mbledhjen dhe ka dhënë mendimet për çështjet që janë shqyrtuar.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Ju uroj punë të mbarë dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush gjatë gjithë vitit të kaluar!

Nëse keni ndonjë sygjjerim për përmirësimin e punës së këshillit, ju lutem mund të merrni fjalën dhe të shpreheni.

Atëherë kemi ndonjë sygjjerim ?

- Nuk kemi atëherë, kalojmë **në pikën 6** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit!

Komisioni Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale gjithashtu shqyrtoi dhe pikën 6 të rendit të ditës dhe sipas propozimit të sjellë nga drejtoria përkatëse e bashkisë për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 89 familje me një fond prej 291.940 lekë. Komisioni vendosi për kalimin, me vota unanime , të këtij projektvendimi.

Faleminderit !

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit!

Ka ndonjë koment përsa i përket pikës 6 nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës? ....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë.



Eneida është përfunduar procesi votimit ?

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Ende.

...(qetësi votohet akoma në chat)...

Atëherë kolegët kanë përfunduar votimin për pikën 6 me të gjitha votat pro.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë me të gjitha votat pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi :** Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për pikën 7, mbi ndryshimin VKB-së nr.17, përsa i përket ndryshimit të listës së dytë të 22 subjekteve përfituese dhe ndryshimin e strukturës së grantit të përfituar për z.Islam Sula si subjekt përfitues nga programi i procesit të rindërtimit në strukturë banimi 3+1, propozon me shumicë votash për ta kaluar pikën 7. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit zonja Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zoti Jani.

**Elio Jani :** Faleminderit Kryetar !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike me shumicë votash propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit z.Jani !

Komente përsa i përket pikës 7, nga ana e këshilltarëve kemi ?.....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem të votojnë të gjithë.

**Eneida Marku (asistenca teknike):** Atëherë kolegët kanë votuar për pikën 7, me 1 apstenim dhe gjithë të tjerat pro.

**Ani Dyrmishi :** Atëherë me gjithë votat pro, asnjë kundër dhe me 1 apstenim miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 8**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi :** Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për pikën 8, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Elio Jani.

**Elio Jani** : Faleminderit Kryetar !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike me shumicë votash propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit z.Jani !

Ka komente përsa i përket pikës 8, nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 8 ? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

**Eneida Marku (asistenca teknike)**: Atëherë kolegët kanë votuar për pikën 8, me 1 apstenim dhe gjithë votimet e tjerat kanë qënë pro pikës 8.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me 1 apstenim dhe me gjithë të tjerat pro, miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 9**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Faleminderit Kryetar !

Për pikën 9, e cila bën fjalë për vlerësimin paraprak të pasurive që preken nga investimi në rrugën “Ksanthipi Zyko” dhe “Abdyl Ypi”, hiqet emri Albert Abazi për pasurinë 2/929, dhe në emër të tij vendoset emri i Hasan Abazi, dhe Xheko Taipi, për pasurinë 2/997, dhe në emër të tij vendoset emri i bashkëpronarëve Lavdrim Balla dhe Drita Musa Balla, për shkak të ndryshimeve të ndodhura në rregjistrat e ASHK-së, komisioni ynë propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 9 . Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zonja Rroshi.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zonja Denisa Luarasi.

**Denisa Luarasi** : Përshëndetje Kryetar ! Përshëndetje kolegë!

Edhe komisioni ynë ra dakort që të kaloj sot për votim pika 9 e rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zonja Luarasi.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar ! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin të dërguar me email nga sekretaria e këshillit, vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit!

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Velçani!

Komente përse i përket pikës 9, nga ana e këshilltarëve kemi ?.....

Nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Kolegët kanë votuar me vota pro pikës 9.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me të gjitha votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 10 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Për pikën 10, Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me miratimin e ndihmës financiare, për 526 subjekte si përfitues të programit të grantit të rindërtimit për kategorinë e dëmit DS1, DS2 dhe DS3, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zonja Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zoti Elio Jani.

**Elio Jani** : Po Kryetar, faleminderit .

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zoti Jani.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Po Kryetar.

Gjithashtu, Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin ra dakort me vota unanime për kalimin në votim. Faleminderit .

**Ani Dyrmishi** : Atëherë komente përse i përket pikës 10, nga ana e këshilltarëve kemi ?.....

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës? .....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë.

Eneida mund të ma konfirmosh nëse është mbyll procesi ?

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Ende jo, Ani.

Ok kolegët kanë votuar pro pikës 10.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me të gjitha votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 11**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Po, Kryetar .

Për pikën 11, në lidhje me miratimin e listës së nëntë të 6 subjekteve përfitese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale, komisioni jonë propozon në mënyrë unanime kalimin e pikës 11. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zonja Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zoti Jani.

**Elio Jani** : Po, Kryetar.

Edhe për pikën 11, Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit zoti Jani.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Gjithashtu dhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin është dakort për kalimin në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Velçani.

Komente përsa i përket pikës 11, nga ana e këshilltarëve kemi ?.....

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës? .....*(ndërkohë qetësi... votohet në chat)* .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem votoni kush nuk ka votuar.

Eni të lutem, kur të përfundoj votimi më njofto.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Atëherë votimi përfundoi për pikën 11 dhe të gjithë kolegët kanë votuar pro.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë me të gjitha votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 11 dhe e fundit e rendit ditës.

Nëse Kryetarja dëshiron të marrë fjalën.

**Emiriana Sako** : Faleminderit për bashkëpunimin.

Ne normalisht vijojmë punën me programin e rindërtimit si prioriteti ynë deri në strehimin e familjeve, siç ishin dhe pikat e sotme, shumica e tyre i përkasin rindërtimit, kështu që sërisht Ju falenderoj për mbështetjen dhe Ju uroj fundjavë të mbarë.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit dhe Ju Kryetare.

Faleminderit të gjithë këshilltarëve që ishin prezent në mbledhje. Duke Ju uruar një fundjavë të mbarë mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe shihemi në mbledhjen e radhës, që do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit në mënyrë elektronike.

Ju faleminderit.

*Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 13 (trembëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI